

**VENDIM**  
**Nr. 592, datë 13.10.2021**

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 904, DATË 24.12.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR CAKTIMIN E RREGULLAVE, TË KATEGORIVE PRIORITARE, MASËS SË PËRFITIMIT, AUTORITETEVE PËRZGJEGJËSE DHE PROCEDURAVE PËR VLERËSIMIN DHE PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE NGA DISA PROGRAME TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 18, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Në vendimin nr. 904, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 20.5 shtohen pikat 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.13 dhe 20.14, me këtë përmbajtje:

"20.6 Përparësi në hedhjen e shortit me qëllim akomodim në objektet e reja kanë:

- a) përfituesit e renditur sipas parashikimeve të pikës 12, të këtij vendimi;
- b) pronarët e njërive të banimit të objekteve të shembura, në trojet e të cilave janë ndërtuar objektet e reja;
- c) përfituesit, të cilët kanë lidhur marrëveshjen paraprake për kalimin e së drejtës së pronësisë, sipas pikës 23, të këtij vendimi.

20.7 Kur nuk mund të rindërtohen në të njëjtin truall, përfituesit akomodohen në zonat e reja për zhvillim.

20.8 Përfituesit e objekteve të reja akomodohen në zonat e reja për zhvillim më të afërta me objektin e dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, nëse struktura e objektit të ndërtuar nuk lejon akomodimin e tyre për shkak të akomodimit të kategorive prioritare, përbërjes familjare dhe strukturës së banesës takuese, sipas tabelave të përcaktuara në këtë vendim.

20.9 Përfituesit akomodohen në njësitë e banimit, në objektet e reja, sipas një shorteu publik dhe të hapur bazuar në:

- a) realizimin e një procesi transparent, mosdiskriminues, të aksesueshëm dhe të kuptueshëm për përfituesit;
- b) njoftimin e të gjithë përfituesve të shpallur me vendim të Këshillit Bashkiak të NJVV-së.

20.10 Shorti konsiston në një përzgjedhje rastësore dhe realizohet në mënyrë transparente nga njësia e vetëqeverisjes vendore, duke marrë të gjitha masat përkatëse për njoftimin dhe pjesëmarrjen e përfituesve në procesin e shorteut publik. Përzgjedhja me short e njërive të banimit në objektet e reja realizohet në mënyrë elektronike nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe, kur kjo nuk është e mundur, shorti zhvillohet në mënyrë manuale.

20.11 Njoftimi i përgjithshëm për shorteun publik duhet të jetë i kuptueshëm dhe i aksesueshëm nga të gjithë dhe bëhet 15 (pesëmbëdhjetë ditë) përpara datës së hedhjes së shorteut nëpërmjet lajmërimeve publike, të cilat afishohen në ambientet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale, si dhe me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetatat më të lexuara në nivel kombëtar. Njoftimi duhet të përmbajë listën e përfituesve dhe vendndodhjen/zonën e objektit.

20.12 Krahas njoftimit të përgjithshëm për hedhjen e shortit, bëhet edhe thirrja, nëpërmjet njoftimit të çdo përfituesi, pjesë e shortit publik për pjesëmarrje në këtë shorte, e cila duhet të përmbajë:

- a) njësinë e vetëqeverisjes vendore që e ka nxjerrë;
- b) emrin, mbiemrin e personit të thirrur, përfitues nga programi i rindërtimit;
- c) përbërjen familjare dhe strukturën e banesës takuese, sipas përcaktimeve të këtij vendimi;
- ç) vendndodhjen/zonën ku është/janë ndërtuar objekti/objektet ose zona sipas marrëveshjes paraprake për kalimin e së drejtës së pronësisë;
- d) vendin dhe datën e organizimit të shorteut publik;
- dh) si dhe pasojat në rast se personi i thirrur nuk paraqitet në shorte.

20.13 Njoftimi shkresor nëpërmjet letërthirrjes bëhet nëpërmjet dorëzimit nga nëpunësi i njësisë vendore ose shërbimi postar. Në çdo rast në lidhje me njoftimin e përfituesit mbahen në konsideratë, për aq sa është e mundur, dispozitat e ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

20.14 Rregulla të hollësishme për mënyrën e zhvillimit të procesit të shorteut publik dhe të hapur miratohen me vendim të këshillave bashkiakë të njësisë të vetëqeverisjes vendore.”.

II. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Arben Ahmetaj**